



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Nenit 15 të ligjit nr.08/L-066. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 04.07.2022 me 01Nr.401-22807 si dhe me rekomandimin e KPF-së datë 14.07.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2022, të mbajtur me datën 29.07.2022 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për Ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale , fondi burimor 10.
2. Në kuadër të programit Planifikimi Urbabn dhe Mjedisi (660), nen-programi Planifikimi urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) nga projekti “ Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Doberdol “ , kodi i projektit (43802) , gjithsejtë shuma prej 16,300.35 € transferohet në projektet si në vijim:
 - “Asfaltimi i rrugëve lokale Zajm – Deiq “ , kodi i projektit (49596) shuma 1,205.00 €
 - “ Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë “ , kodi i projektit (48095) shuma 15,095.35 €
3. Shuma e këtyre mjeteve buxhetore ri-alokohet pasi që në Projektin “ Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Doberdol “ ka përfunduar dhe janë kryer të gjitha obligimet për punët e kryera. Prandaj shuma e mbetur nga ky projekt ri-alokohet në projektet: Asfaltimi i rrugëve lokale Zajm – Deiq, shuma 1,205.00 € dhe ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë shuma 15,095.35 €.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINË

01Nr. 060-27427/22
Klinë, me 02.08 /22



Kryesuesi,
Fadil Gashi